



KOMUNA E SHTIME

SHML "Naim Frashëri Shtime

IAAP-SHTIME



Adresa: Rr. "Isa Boletini", nr 92, KO:72000, Shtime

Nr. i Protokollit: 612/2024

Datë: 27.09.2024

Bazuar në UA 02/2016 për Aktivitete jashtëshkollore, neni 11, pika 1, pas Miratimit të KDSH-së me nr. protokolli 606/2024 të datës 25 shtator 2024.

SHKOLLA E MESME E LARTË "NAIM FRASHËRI" dhe IAAPP NË SHTIME shpall:

OFERTË PËR EKSKURSION

Shkolla e Mesme e Lartë "Naim Frashëri" dhe IAAP në Shtime, organizojnë Ekskursionin e Maturantëve për në Shqipëri prej datës 8. 10. 2024 deri më 11. 10. 2024 sipas Udhëzimit Administrativ për Aktivitetet Jashtëshkollore, nr. 02/2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit (MASHTI).

Ekskursioni gjatë qëndrimit katëditor (4) në Shqipëri do të bëhet sipas relacioneve në qytetet:

Itinerari i paraparë për realizim është si vijon:

- Më 8 tetor 2024,
 - Ora 7:00 nga Shtimja bëhet nisja për Durrës. Vendnisja: Rruga përgjat Shtime-Carralevë, përballë Policisë së Shtimes (rr. "Tahir Sinani")
 - Vendosja në Hotel nga ora 12:00-13:00. Sistemimi nëpër dhoma gjumi. Dhomat të pajisura me jo më shumë se tre shtretër. Secila dhomë të ketë banjon e vetë me ujë të ngrohtë gjatë gjithë kohës. Mbulesa të pastërta dhe të mjaftueshme.
 - Dreka: Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.
 - Më 8 tetor 2024, vizitë qytetit të vjetër të Durrësit dhe amfiteatrit antik; Pagesa për hyrjen e nxënësve në amfiteatër bëhet nga kompania kontraktuese.
 - Darka: 19:00-20:30. Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 9 tetor 2024,
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Vizitë: Nisja në ora 09:00 për në qytetin e Krutës, përkatësisht në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu"; Pagesa për hyrje bëhet nga kompania kontraktuese.
 - Dreka: 14:00. Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Pasdite e lirë: Aktivitete nga kujdestarët e klasave me klasat e tyre.
 - Darka: 19:00-20:30. Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 10 tetor 2024,
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. (Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Vizitë në qytetin e Vlorës, përkatësisht në Shtëpinë e Pavarësisë. Nisja në ora 09:00. Pagesa për hyrje në Shtëpinë e Pavarësisë bëhet nga kompania kontraktuese.
 - Dreka në Restorante të Vlorës: Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Kthimi nga Vlorë në ora 15:00
 - Pasdite e lirë: Aktivitete nga kujdestarët e klasave me klasat e tyre.
 - Darka: 19:00-20:30. Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 11 tetor 2024,
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Ushqimi të jetë kualitativ i bollshëm dhe kalorik përfshirë dhe lëngje.
 - Vizitë kryeqytetit shqiptar – Tiranës. Nisja në ora 09:00.
 - Kthimi për në Kosovë në ora 15:00.

Bartja e nxënësve (afërsisht 140 gjimnaz dhe afërsisht 120 të IAAP) bëhet me autobusë nga agjencioni turistik sipas relacioneve të lartpërmendura, ndërsa akomodimi dhe qëndrimi bëhet në hotel (Durrës). Akomodimi gjatë qëndrimit përfshin: fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik si dhe shërbimin 24 orësh mjekësor.

Ndërkohë, Agjencioni duhet t'i përmbahet të gjitha obligimeve që dalin nga UA 02/2016.

Hoteli duhet të jetë i përshtatshëm. Me jo shumë kate. Nëse ka më shumë se tri kate të posedojë ashensor. Stafi duhet të sigurojë pastërti të ambientit ku rrijnë dhe argëtohen nxënësit. Hoteli duhet të sigurojë po ashtu çmime të njëjta të produkteve të tjera pos atyre që janë në kontratë me të njëjta çmime që janë edhe jashtë hotelit.

Në këtë ofertë mund të konkurrojnë të gjitha agjencitë, të cilat i plotësojnë këto parakushte:

- Të jetë i licencuar
- Të ketë të dokumentuara kontrollet teknike sipas procedurave ligjore
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës
- Autobusët të jenë konfor dhe me klimë
- Dëshmtë për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve
- Të ofrojë përkudësje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit dhe të ketë shërbim të veçantë në raste urgjente.
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve
- Dhe të tjera të parapara me UA 02/2016 që lidhen me ekskursion
- Në bashkëpunim me hotelin e mundshëm, nxënësve dhe personelit përcjellës, t'iu ofrohet siguria 24 orëshe.

Pas shqyrtimit të ofertave nga ana e komisionit i përbërë nga DKA, SHML "Naim Frashëri" dhe IAAP Shtime, do të përzgjidhet oferta më e favorshme dhe me plotësim të kushteve sipas Ligjit. Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në DKA në ndërtesën e Komunës së Shtimes (Kati III).

Afati i paraqitjes me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe web-faqe zyrtare të Komunës së Shtimes.

Ofertat do të hapen me të skaduar afati i ofertës, 7 ditë me datan e shpalljes, në DKA- Shtime ora 13:00. Ofertuesi i përzgjedhur nga komisioni i merr të gjitha obligimet sipas UA nr. 02/2016. Përzgjedhja e ofertuesit bëhet e ditur në ora 15:00.

Drejtori :
Labinot Rexhaj



Drejtori,
u.d Rexhep HASANI

